

UDHËZIM
Nr.13, datë 6.8.2007

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”,
ME NDRYSHIME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat””, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Për prodhuesit, vendas e të huaj të mallrave, që përfshihen në Kodet e Nomenklaturës së Kombinuara; 22 03, 22 04, 22 05 dhe 22 08, të përfshira në kreun “III” të shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar”, veprohet si më poshtë:

1. Për prodhuesit vendas

Organet tatimore, në bazë të të dhënave të personave “tatimpagues të autorizuar të akcizës”, prodhues të mallrave të akcizës, sipas kodeve të Nomenklaturës së Kombinuara, të pajisur me “autorizim akcize” (sipas nenit 4 të ligjit të akcizave) dhe miratim të “magazinës tatimore” (sipas nenit 5 të ligjit të akcizave), mbas plotësimit të shtojcës 1 “Kërkesë për marrjen e autorizimit si tatimpagues akcize” dhe shtojcës 2 “Kërkesë për miratimin e magazinës tatimore” (të bashkëngjitura, sipas pikës 1.3 të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003), përcaktojnë dhe shkallën tatimore që duhet të paguajnë prodhuesit e mallrave të akcizës, sipas shtojcës 1 të ligjit për akcizat.

Shembull:

- Personi “tatimpagues i autorizuar i akcizës”, prodhues i mallrave të akcizës dhe konkretisht “BIRRË” me kodin e NK 22 03, në rast se në shtojcën 1, si më sipër, ka parashikuar sasinë vjetore të prodhimit të birrës mbi 200.000 hektolitra në vit (vit kalendarik), do të paguajë shkallën tatimore prej 40 lekë për litër. Në rast të kundërt, do të paguajë 30 lekë për litër. Kjo do të zbatohet nga organet tatimore dhe për personat “tatimpagues të akcizës”, prodhues të mallrave të akcizës sipas kodeve të NK 22 04, 22 05, 22 08, të përcaktuara në ligjin e akcizave.

Për prodhuesit e huaj

• Personi i autorizuar nga organi tatimor si “tatimpagues i autorizuar akcize” që importon mallra akcize, dhe konkretisht “BIRRË” me kodin e NK 22 03, do të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave:

- Vërtetim, nga shoqëria prodhuese nga e cila do të importohet birra, për sasinë vjetore të prodhuar faktikisht në vitin e mëparshëm kalendarik. Në rast të mos paraqitjes së këtij vërtetimi, organet doganore, zhdoganimin e birrës do ta kryejnë me shkallën tatimore më të lartë, të përcaktuar në ligjin nr.9765, datë 9.7.2007 “Për akcizat”.

• Personi i autorizuar nga organi tatimor si “tatimpagues i autorizuar akcize” që importon mallra akcize, të cilat kërkojnë pullë akcize të Ministrisë së Financave, paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:

- Vërtetim, nga shoqëria prodhuese nga e cila do të importohet vera dhe pijet alkoolike (pavarësisht se ku blihen këto mallra, në magazinat e shoqërisë apo në treg), për sasinë vjetore të prodhuar faktikisht në vitin e mëparshëm kalendarik. Në rast të mos paraqitjes së këtij vërtetimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pajis me pulla akcize të Ministrisë së Financave, personat e autorizuar si “tatimpagues të autorizuar të akcizës”, me shkallën tatimore më të lartë, të përcaktuar në ligjin nr.9765, datë 9.7.2007 “Për akcizat”.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode